

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-1425-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Organizimi I eskursionit për maturantët e shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>Florim Talla B.I.</b>
NUI	<b>810436172</b>
Adresa	<b>Kosova Podujevë Letanc</b>
Vendi	<b>LETANC</b>
Kodi postar	<b>11000</b>
Numri Telefonit	<b>044196565</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Florim Talla</b>
Adresa elektronike	<b>beni-reisen@hotmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>04.05.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### **3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Organizimi I eskursionit për maturantët e shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit  
Kronologji për Aktivitetin e Prokurimit**

**Titulli: Organizimi I eskursionit për maturantët e shkollave të mesme të Komunës së Gjilanit**

**Numri i prokurimit: 651-26-1425-2-1-1**

**Rrjedhja e ngjarjeve:**

**Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 18.03.2026**

**Dorezimi i ofertave: 07.04.2026 në 14:00:00, me afat të shkurtuar duke u thirrur në UA nr. 02/2016, neni 11, pika 2.1**

**B12: Proces Verbali i hapjes me datë 07.04.2026**

**B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letra Standarte për tenderuesin e eliminuar: 22.04.2026**

**Kërkesa për qasje ne oferten e dorëzuar nga i propozuari për kontratë: 22.04.2026**

**Aprovimi i qasjes se kerkuar: 23.04.2026**

**Qasja e mundësuar me datë: 24.04.2026**

**Kërkesa për Rishqyrtim: 27.04.2026**

**REFUZIMI i Kërkesës për Rishqyrtim: 28.04.2026**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

**Procesi i Hapjes se Ofertave është bërë sipas planfikimit dhe është ngritur në platformen E-prokurimi me kohë.**

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan, ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull Organizimi I eskursionit për maturantët e shkollave të mesme të Komunës së Gjilani, aktivitet për të cilin ne si Operatorë Ekonomik kemi pasur interes dhe jemi pjesmarres.**

**Pas fazës së vlerësimit, AK ka publikuar B58-Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letren për Tenderuesin të eliminuar me dy pretendime që nuk qendrojnë, dhe mbi gjitha theksojmë se kemi qenë Operator më i lirë i përgjegjeshëm se ai që është propozuar për kontratë. Ne pajtim me LPP kemi paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim, me arsyshmerine se pretendimet e tyre nuk qendrojnë, dhe se jemi Operatori me ofertën më të lirë të përgjegjeshme, ashtu siq janë precizuar kërkesat dhe kriteret në NJK dhe Dosje të Tenderit.**

**Autoriteti Kontraktues, Ka Refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim, duke tentuar të shtojë pretendime(edhe pse asnjëra nuk janë paraqitur në Raportin e Komisionit të Vlerësimit, por as edhe në B58 Njottimin e AK-së por as edhe në Letren Standarte për Tenderuesin e Eleminuar) dhe do të arsyetojm se asnjëra nga to nuk qendron.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1: Qellimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28: Specifikimet teknike

Neni 51: Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes

Neni 56: Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie e Kontratave

Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 64: Dëshmitë e kërkesave

Neni 69: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72: Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 131 i Ligjit nr. 04/L-042, për Prokurim Publik të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar;

Rregullore nr.001/2022”Për prokurimin Publik

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i

Konsoliduar)

UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN

PUBLIK

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në përputhje me Udhëzuesit Administrativ të nxjerre nga KRPP, ne si OE me interes për këtë aktivitet dhe pjesëmarrës me ofertë, PARASQESIM këtë ANKESË ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës tonë, vendim ky i cili është i pabazuar ligjorisht, i paarsyetuar drejt dhe në kundërshtim me Dosjen e Tenderit, LPP-në dhe Udhëzuesit Administrativ përkatës.

Në refuzim të Kërkesës tonë për Rishqyrtim, AK ka paraqitur arsyetime shtesë dhe të zgjeruara, të cilat tejkalojnë përmbajtjen e vendimit fillestar për eliminim dhe tentojnë të arsyetojnë një vendim të marrë paraprakisht në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe parimet themelore të prokurimit publik.

AK në B58 ka paraqitur arsyet e caktuara dhe specifike për eliminimin tonë. Megjithatë, në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka paraqitur arsye shtesë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e vendimit fillestar për eliminim. Ky veprim përbën shkelje të rënde procedurale dhe cenim të drejtpërdrejtë të të drejtave për ne si OE, si dhe krijon pasiguri juridike dhe hapet rrugë për vendimarrje arbitrare nga Autoriteti Kontraktues.

Një praktikë e tillë e njohur ndryshe edhe si “arsyetim ex post”, është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, përfshirë edhe transparencën, trajtimin e barabartë dhe

sigurinë juridike, si dhe bie ndesh me praktikën e konsoliduar vendimarrëse të OSHP-së.

Rrjedhimisht, cdo arsye shtesë e paraqitur nga AK pas publikimit të vendimit fillestar nuk mund të merret si bazë e ligjshme për justifikimin e eliminimit tonë dhe juridikisht e pavlefshme. Edhe pse, edhe këto arsye shtesë të paraqitura nga ana e AK-së (për tentim forcimin e eliminimit tonë) nuk qendrojnë, dhe do të argumentojmë se bashku me këtë ANKESË,

Kuvendi Komunal Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, me datë 22.04.2026 ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me ç'rast ne si Operator Ekonomik ofertues na ka eliminuar me dy pretendime që nuk qendrojnë, dhe ka propozuar për kontratë Operatorin që është me çmim **130,000.00€** apo **16,600.00€** me e shtrenjët se sa oferta jonë e cila është në vlerë totale **113,400.00€**. Me këtë veprim, me eliminimin të ofertës sonë, Autoriteti Kontraktues po shkakton shpenzim shtesë të panevojshëm për buxhetin publik.

Mënjeherë pas publikimit të propozimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me datë 22.04.2026 kemi kërkuar qasje në dokumentet e procedurës me qëllim ushtrimin efektiv të të drejtave ligjore. AK ka nxjerr Vendim me datën 23.04.2026 për lejimin e pjesëshëm të qasjes, e cila mund të realizohet me datë 24.04.2026 prej orës 13:30-14:00. Në respektim të orarit të planifikuar, ne jemi paraqitur në objektet e Kuvendit Komunal (Autoritetit Kontraktues).

Refuzimi për lejimin e qasjes së plotë në ofertën e të propozuarit për kontratë pothuajse në tërësi, duke u thirrur në mënyrë të përgjithshme në “sekret afarist”, është arsyetim i paqëndrueshëm, pasi dokumentet themelore të procedurës së prokurimit dhe dokumentet që justifikojnë vendimmarrjen administrative nuk mund të fshihen në tërësi nën pretendimin e konfidencialitetit. Me këtë veprim është cenuar parimi i transparencës dhe e drejta e operatorit ekonomik për mjet juridik efektiv, si dhe nuk është në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe në kundërshtim me RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, respektivisht nenin 7.

Neni 7 Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion

7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitur të gjitha faktet dhe argumentet me të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij.

7.6.2 Zyratari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 “Njoftimi mbi vendimin e AK-së”, duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën

Për më shumë, në Procesverbalin për lejimin e qasjes, Autoriteti Kontraktues thekson:

Menqenëse Operatorëve Ekonomik OE “SHARR TRAVEL SH.P.K” ka plotësuar Aneksin 3 Kërkesa për sekrete afariste, duke identifikuar informacionet sekrete dhe afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara: ka specifikuar: Kapacitetet teknike dhe Financiare Kapacitetet ekonomike financiare dhe përshtatshmeria profesionale, por nuk i ka arsyetuar me Deklarat mbi natyrën e dëmit të till material dhe

arsyet pse do te duhej të shfaqen Sekrete Afariste, AK ka vepruar duke u bazuar në Rregulloren e prokurimit publik është neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në, si dhe në Interpretimin e KRPP nr.31. 24.10.2023 Cilat janë veprimet e AK në rast të një kërkesë nga OE për qasje në Dokumentet Zyrtare?

Edhe pse Autoriteti Kontraktues e pohon që OE nuk e ka arsyetuar me Deklaratë pse duhet të konsiderohen Sekret Afarist, ai përsëri i konsideron si të mirëqena.

Ne jemi të bindur që Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe rregulloret tjera në fuqi, respektivisht Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

## **7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

### **1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.**

**Autoriteti Kontraktues, si dhe Komisioni Vlerësues nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tyre për të kërkuar sqarime shtesë, siq do të duhej të vepronte, duke shfrytëzuar nenin 72 dhe 59, por e ka anashkaluar një mundësi të tillë, edhe pse oferta jonë ka qenë OFERTA MË E LIRË E PËRGJEGJESHME, dhe atë në vlerë 113,400.00€, kundrejt të propozuarit për kontratë e cila është 130,000.00€, që i bie 16,600.00€ apo 14.64%. Ritheksojmë:**

**Në çdo procedurë publike, AK ka obligim ligjor të mbrojë interesin publik dhe të sigurojë përdorim racional të mjeteve publike. Eliminimi i ofertës më të lirë mbi baza të paqëndrueshme dhe formale përbën dëm të drejtpërdrejtë financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës**

#### **Pretendimi 1.**

Autoriteti Kontraktues në formularin B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, mbi refuzimin e ofertës tonë është bazuar në DT dhe NJK, saktësisht po e paraqesim siq është paraqitur në Dosje Tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm së paku

Dëshmia 4. Një listë të pajisjeve, duke plotësuar Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, ku listës duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi Librezat me validitet e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për

20 autobusë sipas listës . Në rast grupi, lideri duhet ti plotësoj 60% të vlerës së kërkuar shfrytëzim. Licenca e transportit nga MI, Licenca e kategoris D, Certifikata e Agjencionit transportues, certifikat dhe paratet kundër zjarrit dhe Dëshmia e Kontrollimit teknik të automjetit, të mos jenë më të vjeter se 20 vite, dhe sëpaku ti ken 1200 ulëse

Shenim Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.

*Komisioni i vlerësimit pas egzaminimit dhe krahasimit të tendereve ka konstatuar se në ofeten e tij të dorëzuar "Kontraten me Qira të Autobusësh" ku janë specifikuar 13 Autobuse të marura me shfrytëzim prej "Flutra*

Në radhë të parë dëshirojmë të theksojmë, se VENDIMI për REFUZIMIN e ofertës tonë është i kundërligjshëm, i pabazuar në faktet, kriteret të cilat janë të precizuara në DT dhe NJK, por mbi gjitha është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe economicitetit. Arsyetimi për eliminimin dhe refuzimin e ofertës tonë për mungesë të Licencës D është konstatim i gabuar.

Ne si operatorë me interes për këtë aktivitet të prokurimit të inicuar nga ana juaj, të përcaktuar me Ligjin për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, kemi ofertuar si OE i VETËM, dhe jo si grup i OE-ve. Marrëveshjet për shfrytzim, të cilat ne i kemi dorëzuar, ka qene e precizuar në DT, dhe shprehimisht është lejuar që në rast se OE ka marrëveshje për shfrytzim, ti dorëzoj si të tilla. Ne kemi dorëzuar Licencën siq kërkohet në DT, sepse jemi Operator i VETËM ofertues, dhe jo Grup i Operatorëve Ekonomik.

Në radhë të dytë, Autoriteti Kontraktues, për këtë paqartësi lidhur me dokumentacionin në fjalë, përmes Komisionit të Vlerësimit ka pasur mundësi dhe OBLIGIM që në funksion të konkurrencës së drejtë dhe përdorimit racional të mjeteve publike, të kërkoj sqarime shtesë, para se të merrej vendimi ekstrem për refuzimin/eliminimin tonë, ngase paqartësitë e eventuale me dokumentacionin e mjeteve të siguruara me marrëveshje ka qene lehtësisht e verifikueshme dhe e sqarueshme, **pa NDRYSHUAR SUBSTANCËN E OFERTËS**, me çrast ka shkelur edhe Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i

Tenderëve, përkatesisht pika 40.8:

*40.8 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij /saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.*

Për korrektësi, duam të ju informojmë që ne jemi kompani serioze dhe të vedishëm në lidhje me kërkesat të vendosura nga ana e Autoritetit Kontraktues, të precizuara në Dosje Tenderit dhe Njoftim Për Kontratë, dhe pjesmarrja jonë në aktivitete të prokurimit bëhet vetëm kur i plotësojmë të gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura nga AK. Në këtë kontekst, ju informojmë që ne i posedojmë edhe Licencat D të bashkëpunëtorëve tonë, të cilat po i bashkangjesim me këtë Kërkesë për Rishqyrtim. Si të tilla, edhe pse nuk do të duhej të kërkohen sepse ne kemi dorëzuar licencën D e kemi përmbushur këtë kriter. Për më shumë, edhe sikur të ishim GOE (Grup i Operatorëve Ekonomik), Licenca e kërkuar do të aplikohet vetëm ndaj Grupit në Tërsi, dhe jo INDIVIDUALISHT. Për më shumë, është e përcaktuar edhe në rregulloren 001/2022, përkatesisht:

**26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2**

**(Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.**

Së treti, mbështetur sipas Udhëzuesit Nr.002/2024, Për PLOTËSIM NDRYSHIM E UDHËZUESIT NR.001/2023 Për PROKURIM PUBLIK,

10.Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

**10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së**

PROBLEMI

Si të veprohet

Neni i LPP-së

**Mungon licenca**

**Mund të kerkohen informata sqaruese**

**66**

Pra, Komisioni Vlerësues në kuadër të Autorizimeve për vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave ka vepruar në KUNDËRSHTIM me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloret tjera në fuqi, duke mos përdorur nenin 72 dhe 59, me rastin e Refuzimit/Elemimit e ofertës tonë, por edhe ka dështuar të mbojë interesin publik për të siguruar përdorim racional të mjeteve publike, marrë për bazë që ne kemi dorëzuar OFERTËN më të lirë të Përgjegjeshme.

**Të nderuar Autoritet Kontraktues, nga këto që u thanë më lartë, theksojmë se ne përmbushim të gjitha Kërkesat e precizuara në DOSJE TENDERIT DHE NJOFTIM PËR KONTRATË.**

## **Pretendimi 2.**

Autoriteti Kontraktues në formularin B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, mbi refuzimin e ofertës tonë është bazuar në DT dhe NJK, saktësisht po e paraqesim siq është paraqitur në Dosje Tenderit:  
Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të dokumentuar në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit në fjalë.

Dëshmia 2. Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që

- Vendi i akomodimit – Hoteli i përcaktuar sipas datave të planifikuara, me kategori jo më pakë se 4 yje.
- Numri i nxënësve të akomoduar – Sipërfaqet dhe dhomat e dedikuara në hotele, bazuar në itinerarin e vizitave kulturo-historike që do të vizitohen.
  - Të dhënat e kontaktit – Informacioni i kontaktit për çdo hotel të përfshirë, duke përfshirë emrin e personit përgjegjës, numrin e telefonit dhe adresën.
  - Marrëveshjet me hotelet – Nëse operatori ekonomik nuk është pronar i hoteleve, ai duhet të sigurojë marrëveshje të nënshkruara me hotelet e

Komisioni i vlersimit pas egzaminimit dhe krahasimit te tendereve ka konstatuar se ne oferten e tij te dorzuar “Marrëveshje me hotelet” i mungojnë datat e konfiirin te rezervimit gjat muajit Prill sipas specifikave  
Andaj bazuar ne LPP dhe RROUP tenderi juaj shpallet i pa përgjegjeshem.

Autoriteti Kontraktues në B58-Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të publikuar me datë 22.04.2026 ka pretenduar se në marrëveshjet me hotelet mungojnë datat e konfirmimit të rezervimit gjatë muajit prill, për cka edhe e ka shpallur oferten tonë të pa përgjegjeshme. Ky arsyetim nuk qëndron, sepse vetë Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike ka përcaktuar shprehimisht se organizimi do të bëhet brenda muajit prill, ndërsa koha dhe datat e nisjes do të bëhen në koordinim me njësinë kërkuese.

#### **Aneksi 1.SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

**•Referohuni përshkrimit të çmimeve e cila është e ngarkuar në platëformën elektronike .**

**•Organizimi do të bëhet i menjëhershëm i maturantëve brenda muajit Prill . Për kohën dhe datat e nisjes do të bëhet në kordinim me njësinë kërkuese.**

Pra, në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike është përcaktuar qartë se organizimi do të bëhet brenda muajit prill, ndërsa koha dhe datat e nisjes do të bëhen në koordinim me njësinë kërkuese. Kjo dispozitë ka rëndësi vendimtare juridike, sepse dëshmon se vetë Autoriteti Kontraktues i ka lënë datat të pacaktuara dhe të hapura për koordinim të mëvonshëm. Nëse datat nuk janë përcaktuar nga AK, atëherë askush nuk mund të kërkojë rezervim me data definitive. Një kërkesë e tillë do të ishte e pamundur për t’u përmbushur dhe juridikisht e pavlefshme.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të na eliminojë mbi bazën e një kriteri që nuk e ka shkruar qartë në dosje. Çdo interpretim i mëvonshëm që zgjeron kriteret pas hapjes së ofertave përbën ndryshim të rregullave të garës pas përfundimit të afatit të ofertimit dhe bie ndesh drejtpërdrejt me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike. Për me tepër, kjo është në kundërshtim me LPP dhe RROUP, ku përcaktohet qartë:

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

45.24 Bazuar në nenin 56.3 të LPP, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dosjen e tenderit.

Madje, arsyetimi i AK rrëzohet edhe nga vetë rrjedha procedurale dhe afatet ligjore. Vendimi B-58 është publikuar më 22.04.2026. Të gjithë Operatorët Ekonomik

pjesmarrës kanë të drejtë ligjore të paraqesin kërkesë për rishqyrtim deri me datë 27.04.2026, e përcaktuar me LPP dhe rregulloret në fuqi, marrë për bazë që dita e shpalljes së B58 Njoftimit mbi vendimin e AK-së llogaritet dita 0, Në këtë aspekt në paraqesim Kërkesë për Rishqyrtim, dhe varësisht cili do të jetë vendimi i AK-së, ekziston afati ligjor për paraqitje ankese në OSHP, nëse Kërkesa për Rishqyrtim refuzohet.

Kjo nënkupton se kontrata nuk mund të nënshkruhet para përfundimit të këtyre afateve ligjore, praktikisht jo para muajit maj. Pra, edhe po të ishin dorëzuar rezervime me data fikse gjatë muajit prill, ato data do të kalonin para nënshkrimit të kontratës. Kjo dëshmon qartë se kërkesa e pretenduar nga AK është jo vetëm e pashkruar, por edhe e pakuptimtë dhe e pazbatueshme në praktikë.

Ne se bashku me ofertën tonë kemi dorëzuar dy konfirmime zyrtare nga hotele të ofruara për akomodim, me kapacitete 800 dhe 750 shtretër, përkatësisht gjithsej 1,570 shtretër. Kjo tejkalon ndjeshëm minimumin prej 1,200 shtretërve të kërkuar nga AK. Me këtë dokumentacion është dëshmuar pa asnjë dyshim kapaciteti real, serioziteti i ofertës dhe mundësia konkrete për sigurimin e akomodimit sipas çdo date që cakton Autoriteti Kontraktues në fazën e realizimit. Gjithashtu, në konfirmimin e rezervimeve është theksuar që akomodimi do të behet pas kërkesës nga ana jonë si palë e marrëveshjes, kërkesë të cilën ne do ta bëjm pas kordinimit me njesinë kërkuese.

Është me rëndësi të theksohet se vetë Dosja e Tenderit parasheh edhe Sigurimin e Ekzekutimit të Kontratës. Ky instrument ekziston pikërisht për të mbrojtur Autoritetin Kontraktues në rast se operatori ekonomik fitues nuk përmbush obligimet kontraktuale, përfshirë sigurimin e akomodimit sipas datave të caktuara. Pra, AK e ka pasur tashmë mekanizmin ligjor dhe financiar të garancisë. Për këtë arsye, eliminimi ynë mbi baza hipotetike se ndoshta në të ardhmen mund të mos ketë vende të lira është arbitrar, disproporcional dhe në kundërshtim me logjikën e sistemit të prokurimit publik.

Në procedurat e prokurimit vlerësohen dokumentet dhe kapaciteti i dëshmuar në kohën e ofertimit, jo supozimet e pabazuara për ngjarje të ardhshme. Ne kemi dëshmuar kapacitet mbi kërkesën minimale, kemi paraqitur konfirmime zyrtare dhe kemi pranuar detyrimin kontraktual të garantuar me sigurim ekzekutimi në rast nënshkrimi të kësaj kontrate. Çdo gjë tjetër është interpretim subjektiv dhe jo standard ligjor i vlerësimit.

Rrjedhimisht, oferta jonë është e përgjegjshme dhe plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, si oferta më e lirë e përgjegjshme.

Interpretimi i bërë nga AK për data fikse rezervimi përbën shtim kriteri pas hapjes së ofertave dhe cenon parimet e transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë.

Eliminimi jonë nuk është rezultat i mungesës reale të kapaciteteve apo mospërmbushjes së kërkesave, por rezultat i interpretimeve arbitrare, refuzimit të sqarimeve dhe vendosjes së kriterëve pas hapjes së ofertave.

**Prandaj kërkojmë:**

## **APROVIMIN E KËRKESËS PER RISHQYRTIM**

### **ANULIMIN E VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES LËNDA TË KTHEHET NË RIVLERSIM**

**DHE PAS RIVLERËSIMIT**, në përputhje me kriteret e publikuara në DT dhe NJK të shpalllemi Operatori fitues, si oferta më e lirë e përgjegjeshme për thirrjen e AK-së për këtë procedurë.

Me datë 28.04.2026, AK ka ngarkuar ne sistemin Eprokurimi Refuzimin e Kërkeses për Rishqyrtim. Po e paraqesim:

*Përgjigjeje ndaj pretendimeve ankimor nr 2 dhe 3.*

*Lidhur me pretendimin e dytë dhe tretë: AK, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues ka vendosur të trajtohen sbashku pasi që janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, në raport me dosjen e tenderit dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar , të cilat mund të verifikohen lehtësisht nga dokumentacioni i prokurimit në e-prokurim, ka gjetur se nuk qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se gjetjet tregojnë se oferta/tenderi i paraqitur nga OE ankues nuk i ka përmbushur kriteret minimale dhe të nevojshme të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të parashtruara në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për shkak se dokumentacioni i ofruar nga OE ankues nuk përputhet me kriteret e specifikuara në secilën nga kërkesat/dëshmitë e kerkuara dokumentare të kriterit të lartcekur (kapacitetit profesional) të dosjes së tenderit. Nga ky aspekt, AK konstaton se arsyeja e eliminimit në këtë pikë qëndron pasi që vlerësimi i ofertës së tij është bërë në përputhje me nenin 59 te LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, në përputhje me nenin 40 të Rregullorës për Prokurimin Publik nr. 002/2024, për faktin se oferta/tenderi i OE ankues nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit, për arsyet e detajuara më poshtë:*

*Nuk ka plotësuar kërkesat kualifikuese dhe dëshmit sipas DT-së, pasi që mekanizmi i ofruar nuk ka licenc D, ku kërkohet për transporte jashtë vendit por nga dokumentacioni i ofruar është se janë vetëm për transport të brendshëm, po ashtu në kërkesë sipas Dt-së dhe NJK, janë kërkuar autobus OE ankues ka ofruar minibus.*

*Sa i përketë marrëveshjes së dorëzuar nga OE ankues nuk e ka përmbushur ankesin 1, ku kërkohet që në marrëveshje të jenë te cekura periudha kohore e organizimit dhe sisitemit te maurantëve, por në marrëveshje është cekur se hoteli do të shikojë mundësitë se kur dhe në cilat periudha do të mundësohet akomodimi, ky bie ndeshë edhe me Udhëzimin administrativ të MASHT-së për periudhen kohore të organizimit të ekzurzoneve.*

*Lidhur me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës ka vepruar konformë nenit 59 te LPP-së. Andaj këto prete dimev ankimore janë të pabazuara.*

**KUNDËRSHTIM NDAJ PËRGJIGJES SË AK-së PËR PRETENDIMET NR. 2  
DHE 3**

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimet ankimore nr. 2 dhe 3 është e përgjithësuar, pa analizë konkrete dhe në kundërshtim me faktet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ne si Operatorë Ekonomik.

AK në mënyrë deklarative pretendon se ne nuk ka përmbushur kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional, duke iu referuar nenit 59 të LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores, pa specifikuar saktë dhe në mënyrë të argumentuar se cilat kërkesa konkrete nuk janë përmbushur dhe në çfarë mënyre dokumentacioni i dorëzuar bie ndesh me to. Aq më shumë kur ne bashkë me Kërkesën për Rishqyrtim i kemi ngarkuar edhe Licencat D për kompanitë me të cilat kemi marrëveshje për shfrytëzimin e autobuseve.

AK pretendon për mungesë të licencës D, për autobusë të cilët ne i kemi në marrëveshje noteriale, dhe ne e kemi dorëzuar Licencën D. Nëse AK ka pasur paqartësi lidhur me përmbajtjen e licencave, ka qenë i obliguar që, në bazë të nenit 72 dhe nenit 59 të LPP-së, të kërkojë sqarime nga ne.

Në Kërkesën për Rishqyrtim e kemi elaboruar që ne nuk kemi ofertuar si GOE (Grup i Operatorëve Ekonomik), por SI Operatorë i vetëm. Në aspektin e Kërkesave dhe mundësit teknike dhe profesionale, ashtu siq ka qene e precizuar ne DOSJE TE TENDERIT dhe NJOFTIM PER KONTRATE ne kemi pasur marrëveshje, dhe si të tilla i kemi dorëzuar. Edhe sikur të kishim aplikuar si GOE, Autorizimi/ licenca do konsideroj e përmbushur nese njeri nga anëtarët do ta dorëzonte, siq edhe është e percaktuar:

**(Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.**

Autoriteti Kontraktues, për këtë paqartësi lidhur me dokumentacionin në fjalë, përmes Komisionit të Vlerësimit ka pasur mundësi dhe OBLIGIM që në funksion të konkurrencës së drejtë dhe përdorimit racional të mjeteve publike, të kërkojë sqarime shitesë, para se të merrej vendimi ekstrem për refuzimin/eliminimin tonë, ngase paqartësitë e eventuale me dokumentacionin e mjeteve të siguruara me marrëveshje ka qene lehtësisht e verifikueshme dhe e sqarueshme, pa NDRYSHUAR SUBSTANCËN E OFERTËS, me çrast ka shkelur edhe Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, përkatesisht pika 40.8:

*40.8 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij /saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen me shkrim përmes platformës elektronike, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.*

AK pretendon që Licenca D është vetëm për transport brenda vendin, pa pasur njohuri bazike për funksionimin dhe implementimin e licencave. Ne kemi dorëzuar LICENCEN D, e cila mbulon transportin vendor dhe nderkombetar. Gjithashtu se bashku me kërkesë për rishqyrtim, por edhe me këtë ANKESË kemi dorëzuar edhe LICENCAT D, për

kompanitë me të cilat kemi marrëveshje të noterizuar dhe të dorëzuar me ofertë, të cilat janë lehtë të verifikueshme, mirëpo AK ka bërë interpretim të gabuar.

Pretendimi shtesë, që nuk ishte paraqit me vendimin B58, me rekomandimet e Komisionit Vlerësues, që kinse ne kemi dorëzuar minibus dhe është kërkuar autobusë është i pavlefshëm proceduralisht dhe i pasaktë faktikisht, për këto arsye:

Ky nuk ka qenë shkak eliminimi në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (B58)

AK nuk mund të shtojë arsye të reja pas vendimit, për të tentuar për të justifikuar eliminimin, si dhe faktikisht i pasaktë, për këto arsye:

Ne kemi ofruar 20 autobusë, siq ka qenë kërkesë e DT dhe NJK. Nëse ka qene kerkesa per 20 autobus, dhe ne se bashku me 20 autobusë, kemi dorëzuar edhe një minibus që si kompani e posedojmë nuk e cenon përmbushjen e kriterit, përkundrazi minibusi është element shtesë dhe nuk ka qenë objekt vlerësimi për përmbushjen e minimumit.

**Ky pretendim shtesë nga ana e AK-së është i pabazuar, dhe nuk mund të përdoret si arsye për eliminim.**

Autoriteti Kontraktues, duke tentuar me cdo forme eliminimin tone, edhe pse jemi operatori me oferten me te lire te pergjegjshme, ne menyre te gabuar ka interpretuar kriteret te cilat vete i ka vendos, saqe ne Refuzimin e kerkeses per rishqyrtim, shton edhe kriteret te cilat nuk jane pjese e DT as NJK.

AK pretendon se ne nuk kemi specifikuar periudhën kohore dhe sistemimin e maturanëve në marrëveshje. Ky pretendim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Dosjen e Tenderit.

**Në Aneksin 1 është përcaktuar qartë se:**

**organizimi bëhet brenda muajit prill;  
datat dhe koha caktohen në koordinim me njësinë kërkuese.**

Kjo nënkupton se:

***nuk ka pasur data fikse në momentin e ofertimit;  
nuk është kërkuar rezervim me data konkrete;***

***nuk është kërkuar sistemim i detajuar paraprak.***

Në këto rrethana, kërkesa e AK për periudha konkrete në marrëveshje përbën interpretim të zgjeruar të kriterit dhe shtim të kriterit pas hapjes së ofertave, gjë që është e ndaluar. Nesi Operatori Ekonomik, së bashku me ofertën me tonë, kemi dorëzuar marrëveshje valide me hotelet përkatëse, si dhe gjithë dokumentacionin e kërkuar, ku është dëshmuar kapacitet minimal prej 1,200 shtretërve. Për më tepër, kemi ofruar kapacitet real prej 1,570 shtretërish, duke e tejkaluar ndjeshëm minimumin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe në mënyrë specifike me Aneksin 1, ku përcaktohet se datat e realizimit të ekskursionit caktohen në koordinim me njësinë kërkuese, Ne si Operator Ekonomik deklarojmë dhe garantojmë se, në cilësinë e operatorit fitues, do të sigurojë akomodimin dhe realizimin e shërbimit për të gjitha datat që caktohen nga

Autoriteti Kontraktues, duke rezervuar kapacitetet përkatëse në përputhje me kërkesat kontraktuale.

Ky angazhim nuk është hipotetik, por i bazuar në kapacitetin real të dëshmuar dhe në marrëveshjet ekzistuese me operatorët hotelierë, të cilat mundësojnë sigurimin e akomodimit sipas çdo termini që caktohet nga AK.

Për më tepër, realizimi i këtij obligimi është i garantuar edhe përmes mekanizmit të Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës, i cili parashihet në Dosjen e Tenderit dhe që shërben si garanci për Autoritetin Kontraktues në rast të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuale.

Rrjedhimisht, çdo pretendim i AK lidhur me pasigurinë e rezervimit është i pabazuar, hipotetik dhe në kundërshtim me vetë mekanizmat mbrojtës të paraparë në dokumentacionin e tenderit.

Për më tepër, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rezervime gjatë muajit prill (si kriter shtesë i vendosur gjatë fazes së vlerësimit) është jo vetëm i pabazuar juridikisht, por edhe plotësisht i paqëndrueshëm në aspektin faktik dhe procedural. Në momentin e paraqitjes së kësaj ankese, data është **04.05.2026**, që nënkupton se muaji prill ka përfunduar. Pra, rrjedhimisht:

çdo rezervim eventual i bërë për data të muajit prill do të ishte i pashfrytëzueshëm dhe i pavlefshëm në momentin e nënshkrimit të kontratës; kërkesa për rezervime fikse për një periudhë që tashmë ka kaluar është e pamundur për t'u përmbushur; dhe një interpretim i tillë e vendos operatorin ekonomik në një situatë absurde, ku kërkohet të dëshmojë një kapacitet për një periudhë që nuk mund të realizohet më.

Ky fakt dëshmon qartë se arsyetimi i AK nuk është i bazuar në realitetin procedural të prokurimit publik, por përkundrazi është artificial dhe i ndërtuar për të justifikuar një vendim të marrë paraprakisht. Në praktikë, kërkesa e AK do të kishte kuptim vetëm nëse: datat e realizimit do të ishin të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Meqenëse asnjëra nga këto nuk qëndron, rezulton se kërkesa për rezervime të muajit prill (si kriter shtesë i vendosur gjatë fazës së vlerësimit) është jo vetëm e paarsyeshme, por edhe në kundërshtim me vetë rrjedhën ligjore të procedurës së prokurimit.

Për rrjedhojë, eliminimi jonë mbi këtë bazë përbën vendim të pabazuar, disproporcional dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, aq më tepër kur ne kemi dorëzuar marrëveshjet me hotelet përkatëse, dhe kurdo që njesia kërkuese i vendos datat, bashke me AK-në, ne do të jemi të gatshëm në implementim të kontratës.

Të nderuar anëtarë të Panelit të OSHP-së,

Nga të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka devijuar nga kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, duke bërë interpretim të zgjeruar të kriterëve dhe duke vendosur kërkesa shtesë që nuk kanë qenë të parapara në dokumentacionin e prokurimit, si dhe mos respektim të Ligjit për Prokurim Publik dhe Rregulloreve tjera në fuqi. Mos vlerësimi i drejtë dhe të paanshëm, është siç përcaktohet në LPP.

Një qasje e tillë ka çuar në eliminimin tonë, jo mbi bazë të një vlerësimi real dhe substancial të ofertës, por mbi një vlerësim formal, të ngurtë dhe të orientuar drejt një rezultati të paracaktuar. Në ofertën tonë kemi deshmuar përmbushje të plotë të kërkesave të Dosjes së Tenderit, kapacitet mbi minimumin e kërkuar, dhe ofertë ekonomikisht më të favorshme.

Përkundër kësaj, jemi eliminuar mbi baza të paqarta dhe të paarsyeshme, çka cenon rëndë edhe parimin e trajtimit të barabartë dhe paanshmërisë, parimin e proporcionalitetit si dhe parimin e efikasitetit dhe përdorimit racional të fondeve publike.

Një vendimarrje e tillë krijon gjithashtu dyshim të bazuar për favorizim dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke dëmtuar konkurrencën e drejtë dhe besimin në procesin e prokurimit publik.

**Për më tepër, eliminimi i një operatori ekonomik të përgjegjshëm dhe në aspektin financiar shumë më të favorshëm rezulton drejtpërdrejt në dëmtim të buxhetit publik. Në këto rrethana, konsiderojmë se ndërhyrja e Panelit të OSHP-së është e domosdoshme për të rikthyer ligjshmërinë, për të garantuar trajtim të drejtë dhe për të mbrojtur interesin publik.**

Prandaj kërkojmë:

## **APROVIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM**

## **ANULIMIN E VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES LËNDA TË KTHEHET NË RIVLERËSIM**

**DHE PAS RIVLERËSIMIT**, në përputhje me kriteret e publikuara në DT dhe NJK të shpallëmi Operatori fitues, si oferta më e lirë e përgjegjshme për thirrjen e AK-së për këtë procedurë.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Për ne si Operator Ekonomik, pjesmarrës në këtë aktivitet nuk ka dëme materiale, MIRËPO Autoriteti Kontraktues në çdo procedurë publike ka obligim ligjor të mbrojtë interesin publik dhe të sigurojë përdorim racional të mjeteve publike. Eliminimi i ofertës më të lirë mbi baza të paqëndrueshme dhe formale përbën dëm të drejtpërdrejtë financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, duke propozuar për kontratë OE me cmim më të lartë se oferta jonë, cka është DËM i drejtpërdrejtë i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe parasë publike.**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*